Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizreń – Prizren Belediyesi

**Drejtoria e Inspektorateve**
Inspektorati i Ndërtimtarisë
Nr. 17-354-zyrtarisht
Dt. 23. 4.2014
**P r i z r e n**

**Nga:** Inspektorati i Ndërtimtarisë

**Për:** OJQ " Ec Ma ndryshe " rr. Saraqeve nr.5 Prizren

**Lënda:** Përgjigje ne kërkesat e OJQ " Ec Ma ndryshe "

1. Inspektorati i Ndërtimtarisë sipas kërkesës nr. 001-351-40682 i datës 15.4.2014 te OJQ"EC MA NDRYSHE" ne lidhje me mbindërtimin e objektit kolektiv banesor i cili gjendet ne rr. Hadi Kantargji nr.149 **hyrja** IV (91/20), jep këtë përgjigje : inspektori i ndërtimtarisë gjatë kontrolles inspektuese ka konstatuar se investitori Valon Ahmeti dhe te tjerë kane filluar te bëjnë mbindërtim ne objektin kolektiv .Te njejtët posedoje leje nga Drejtoria e Urbanizmit për renovimin e kulmit të banesës kolektive por nuk posedojnë leje për mbindërtim (lartësi e vogël muresh) ne objektin ekzistues. Sipas detyrës zyrtare inspektoret e ndërtimtarisë kane përpiluar procesverbale janë lëshuar aktvendim për ndalim punimesh,aktvendim për rrenim vullnetar,inicim te procedurës kundërvajtje e deri ne konkluzion për ekzekutim te dhunshëm. Ne këtë rast fjala është për tejkalime te vogla qe nuk ndikon ne rrezikshmërinë e objektit ekzistues.

**2.** Inspektorati i Ndërtimtarisë sipas kërkesës nr.001-351-40683 i datës 15.4.2014 te OJQ"EC MA NDRYSHE" ne baze te kompetencave lëndore jep këto përgjigje për pyetjen e parashtruara:
Ne lidhje me mbindërtimin e objekteve kolektiv banesor te cilët gjinden ne lagjen „Jeni Mahallë", inspektoret e ndërtimtarisë kane zhvilluar procedure administrative dhe kane konstatuar se tejkalimet qe janë bere ne objektet kolektive janë pa leje ndërtimore dhe për te njëjtat tejkalime i pret fati sikurse te gjitha objektet tjera qe kanë mbindërtime ne qytet qe do të thotë presim një vendim ne nivel komunal për te gjitha rastet te trajtohen njësojë.

për Inspektori ,
Enver Bytyqi

D r e j t o r i
Msc. Bedri Bytyqi

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA * KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E PRIZRENIT